



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1162 Prot.
12

Patos, më 09 / 10 / 2026

NJOFTIM

**Dëgjesë publike me temë:
“Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin “Paketa e Maleve”**

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1162 prot, datë 01.04.2026 të drejtorisë së Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile për zhvillimin e dëgjesës publike me temë: Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin në “Paketën e Maleve”.

Ju njoftojmë se:

Ditën e **Mërkurë** në datë **13.05.2026, ora 10:00**, në fshatin Kuqar do të organizohet dëgjesa publike me pjesëmarrje të: anëtarë të Këshillit Bashkiak; kryetarë të fshatrave; banorë të fshatit; posedues jopronarë të tokave; shoqëri civile; subjekte juridike; qytetarë të interesuar; grupe të tjera interesi dhe përfaqësues të bashkisë Patos me temë: “Zhvillimi i zonave prioritare për aplikimin “Paketa e Maleve”.

Këto konsultime publike synojnë informimin dhe saktësimin e poseduesve jopronarë të pasurive në zonat me potencial zhvillimi lidhur me aplikimin “Paketa e Maleve”.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: info@bashkiapatos.gov.al.

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjesë publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

KRYETARI
Fation Duro